



BASHKIA
TIRANË

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Geci” shpk

Adresa: Tirana International Hotel, Sheshi Skënderbej, Nr.8, Tirane.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Shtim i sipërfaqeve të varrezave publike “Sharrë”.

Numri i referencës së procedurës: REF-00765-12-20-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Shtim i sipërfaqeve të varrezave publike “Sharrë”.

Fondi limit: 128,698,567.11 (njëqind e njëzet e tetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 30 (tridhjetë) javë kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 21.01.2019, ora 12:00.

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 51 datë 24.12.2018.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Inerti” shpk
J66926804L

NUIS

Vlera e ofertës = **86,186,750** (tetëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

2. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Bajrami N” shpk & “Meteo” shpk

NUIS

K027272020

NUIS

L26310801C

Vlera e ofertës = **96,132,590.4** (nëntëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e tridhjetë e dy mijë e

pesëqind e nëntëdhjetë pikë katër) lekë pa TVSH.

3. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Agi Kons” shpk & “BE-IS” shpk

NUIS

K21622001M

NUIS

K71412003A

Vlera e ofertës = **104,401,244** (njëqind e katër milion e katërqind e një mijë e dyqind e dyzetë e katër) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “Viante Konstruksion” shpk

NUIS

K47103804L

Vlera e ofertës = **107,458,895.16** (njëqind e shtatë milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë pikë gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk

NUIS J68310708M

Vlera e ofertës = **109,942,896** (njëqind e nëntë milion e nëntëqind e dyzetë e dy mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

6. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Everest” shpk & “Klajger Konstruksion” shpk

NUIS J78311921L

NUIS

K51423028P

Vlera e ofertës = **109,961,003** (njëqind e nëntë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e tre) lekë pa TVSH.

7. Operatori ekonomik “Geci” shpk

NUIS K71829801O

Vlera e ofertës = **121,883,207.78** (njëqind e njëzetë e një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e shtatë pikë shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

8. Operatori ekonomik “Bami” shpk

NUIS J94416206R

Vlera e ofertës = **123,310,055** (njëqind e njëzetë e tre milion e treqind e dhjetë mijë e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

9. Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk

NUIS K71401004W

Vlera e ofertës = **123,782,034.18** (njëqind e njëzetë e tre milion e shtatëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tridhjetë e katër pikë tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Inerti” shpk

NUIS

J66926804L

- Operatori ekonomik “Inerti” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobot uji me targa AA 990 GY. Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur rezulton se mjeti i sipërcituar është Autobot uji i montuar = Kamionçinë me targa AA 990 GY + Depozitë uji, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17 ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobot uji”.
- Operatori ekonomik “Inerti” shpk nuk ka paraqitur foto për mjetin elektrosaldatriçe, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, gërma “d”.
- Referuar dokumentacionit të paraqitur, rezulton se operatori ekonomik “Inerti” shpk nuk disponon Rul me kompresor, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17 ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Rrul me kompresor për ngjeshje asfalti”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Inerti” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

2.Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Bajrami N.” shpk & “Meteo” shpk

NUIS

K027272020

NUIS

L26310801C

- Shoqëria “Meteo” shpk për muajin Tetor 2018 ka paraqitur Formularet e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të një subjekti tjetër dhe jo të shoqërisë “Meteo” shpk, sic është përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 4, germa “b” ku ndër të tjera parashikohet se: “Operatori Ekonomik duhet të paraqese Listëpagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Nëntor 2017 - Nëntor 2018 shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore”.
- Deklarata mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7, nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik, dhe konkretisht Shoqëria “Meteo” shpk, nuk është paraqitur sipas formatit të kërkuar, pasi brenda një deklaratë janë të dhenat e dy subjekteve të ndryshme, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 1, germa “b”.

- Shoqëria “Bajrami N.” shpk nuk ka paraqitur Librezën e punës për Inxhinierin e Mjedisit, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për mjetet “Eskavator me goma”, të deklaruara në Shtojcen 10, u konstatua se janë paraqitur vetëm me Deklarata Doganore dhe jo dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, germa “a”, ku përcaktohet se: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes”.
- Referuar Shtojcës 10, Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) Rrul me vibrim. Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur mbi disponimin e tij, rezulton se mjete të deklaruar është Rrul me kompresor dhe jo Rrul me vibrim, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 1 (një) Rrul me vibrim”.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Bajrami N” Shpk & “Meteo” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobetoniere me targa AA 081 MD. Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur mbi disponimin e saj, rezulton se mjete është në pronësi të një subjekti tjetër dhe s’është në pronësi të anëtarëve të këtij Bashkimi Operatorësh ekonomik. Si rrjedhojë për mjetin Autobetoniere me targa AA 081 MD, nuk është paraqitur Kontrata e Qirasë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, gërma “a” ku përcaktohet se: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë

20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Bajrami N.” shpk & “Meteo” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

3. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Agi Kons” shpk & “BE-IS” shpk

NUIS

K21622001M

NUIS

K71412003A

- Operatori ekonomik “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera.....” , pasi drejtuesi teknik i Bashkimit të Operatorëve Ekonomik, i deklaruar për këtë procedurë prokurimi rezulton të jetë i anagazhuar gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës për procedurën e shpallur fitues me objekt: *“Rehabilitim i rrugës dhe qendrës së lagjes Sheheler”*.
- Pas verifikimit të dokumentacionit shoqëruar për mjetet “Eskavator me goma”, të deklaruara në Shtojcën Nr.10, u konstatua se njëri nga eskavoret e deklaruar është paraqitur vetëm me Deklarata Doganore dhe jo dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, germa a), ku përcaktohet se: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes.

4. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Viante Konstruksion” shpk

NUIS

K47103804L

- Inxhinieri i Mjedisit i deklaruar nga Operatori ekonomik “Viante Konstruksion” shpk nuk është i pajisur me Çertifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Shoqëria “Viante Konstruksion” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Autopompë

betoni me targa TR 6149 L. Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur për mjetin e sipërcituar rezulton se nuk është paraqitur Akti i Pronësisë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, gërma “a”.

- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik ka deklaruar se disponon 4 (katër) Autobetoniere përkatësisht Autobetonieren DBM 2500 për të cilën ka paraqitur vetëm Deklaratën Doganore; Autobetonieret me targa TR 4397 P si dhe me targa TR 9342 M, për të cilat nuk janë paraqitur Aktet e Pronësisë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, gërma “a”.
- Gjithashtu Operatori ekonomik “Viante Konstruksion” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) Autobote uji përkatësisht me targa AA 278 LN si dhe me targa AA 219 HY. Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues, u konstatua se mjetet e deklaruara nga Operatori ekonomik rezultojnë të jene Autobote për transport karburanti, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 1 (një) Autobot uji”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Viante Konstruksion” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

5. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk

NUIS

J68310708M

- Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk nuk plotëson pikën 7 të Kapaciteti Teknik të Dokumentantave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë/2 (dy) punonjës pllakashtrues” pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për 2 punonjësit pllakashtrues të kërkuar.
- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobot uji me targa TR7763U. Pas verifikimeve të dokumentacionit shoqërues për mjetin e sipërcituar, u konstatua se mjete rezultojnë të jetë Autobot uji i montuar = Kamion + Depozitë uji, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobot uji”.
- Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk nuk plotëson pikën 17, gërma “e” të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit”, pasi për

mjetin rrul me vibrim Bomag të deklaruar me faturë tatimore, nuk ka paraqitur foto ndërsa Rruli AMANN i deklaruar si rrul me vibrim nga verifikimi i fotos rezulton rrul me kompresor.

- Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk nuk plotëson pikën 17, gërma “e” të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit”*, pasi për mjetet vibrator thellësie, elektrosaldatrice dhe gazogjen nuk ka paraqitur foto.

6. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Everest” shpk & “Klajger Konstruksion” shpk

NUIS J78311921L

NUIS

K51423028P

- Për të vërtetuar disponimin e mjetit Kamion me kapacitet mbajtës minimumi 20 Ton, Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar në Shtojcën 10 Kamionin me targa AA 208 VB. Pas verifikimit të dokumentacionit, rezulton se për mjetin e sipërcituar nuk është paraqitur Çertifikata për transport mallrash brenda vendit, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, gërma “a”. Për sa më lart, Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, ku ndër të tjera përcaktohet se : *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 1 (një) kamion me kapacitet mbajtës minimum 20 Ton”*.
- Referuar Shtojcës 10, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Everest” shpk & “Klajger Konstruksion” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) kamiona me kapacitet mbajtës 10 – 15 Ton përkatësisht me targa AA 386 NJ si dhe me targa TR 9708 P. Pas verifikimit të dokumentacionit rezulton se kamioni me targa AA 386 NJ ka kapacitet mbajtës 16.8 Ton; mjeti me targa TR 9708 P ka kapacitet mbajtës 10 Ton. Për mjetin me targa TR 9708 P nuk është paraqitur Akti i Pronësisë si dhe Çertifikata për transport mallrash brenda vendit, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, gërma “a”. Për sa më lart, Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, ku ndër të tjera përcaktohet se : *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 1 (një) kamion me kapacitet mbajtës 10 Ton deri në 15 Ton”*.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) Kamionçinë me targa TR 2125 R, e cila referuar dokumentacionit shoqërues rezulton se ka kapacitet mbajtës 5.1 Ton, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, ku ndër të tjera përcaktohet se : *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 1 (një) kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 Ton deri në 5 Ton”*.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk ka paraqitur foto për mjetet elektrosaldatrice; vibrator thellësie, asfaltoshtruese, gazogjen si dhe për mjetin e deklaruar Rrul Bomag,

çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, gërma “e”.

- Referuar Shtojcës 10, Bashkimi I Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobot me targa DR 2809 D. Pas verifikimeve rezulton se mjeti është Autobot nafte dhe jo Autobot Uji, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, ku ndër të tjera përcaktohet se : *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 1 (një) Autobot uji”*.
- Në fotot e paraqitura për eskavatorët me targa ADMT 74 dhe ACMT 17 targa e mjeteve nuk është e dukshme, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, gërma “e”.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) Autopompë për hedhje betoni me targa AA 397 SP. Pas verifikimit të dokumentacionit rezulton se për mjetin e sipërcituar nuk është paraqitur Akti i Pronësisë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, gërma “a”.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobetoniere me targa AA 768 KS. Pas verifikimit të dokumentacionit rezulton se për mjetin e sipërcituar nuk është paraqitur Akti i Pronësisë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, gërma “a”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Everest” shpk & “Klajger Konstruksion” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

7. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Bami” shpk

NUIS J94416206R

- Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit teknik, u konstatua se Inxhinieri i Mjedisit i deklaruar nga Operatori ekonomik “Bami” shpk nuk është i pajisur me Çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Operatori ekonomik “Bami” shpk ka paraqitur dokumentacion vetëm për 1 (një) punonjës Elektriçistë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7 ku përcaktohet se: *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte*

juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:

- 2 (dy) punonjës teknik ndërtimi
- 2 (dy) punonjës saldator
- 2 (dy) punonjës pllakashtrues
- 2 (dy) punonjës hidraulikë
- 3 (tre) punonjës karpentier
- 2 (dy) punonjës hekurkthyes
- **2 (dy) punonjës elektrikistë**

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; deshmite e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

- Operatori ekonomik “Bami” shpk ka paraqitur dokumentacion vetëm për 2 (dy) punonjës kapentier, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7 ku përcaktohet se: *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:*

- 2 (dy) punonjës teknik ndërtimi
- 2 (dy) punonjës saldator
- 2 (dy) punonjës pllakashtrues
- 2 (dy) punonjës hidraulikë
- **3 (tre) punonjës karpentier**
- 2 (dy) punonjës hekurkthyes
- 2 (dy) punonjës elektrikistë

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; deshmite e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

- Operatori ekonomik “Bami” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion për punonjësit Teknik Ndërtimi, punonjësit Pllakashtrues, punonjësit hidraulikë, punonjësit hekurthyes, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7 ku përcaktohet se: *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike*

private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:

- **2 (dy) punonjës teknik ndërtimi**
- *2 (dy) punonjës saldator*
- **2 (dy) punonjës pllakashtrues**
- **2 (dy) punonjës hidraulikë**
- *3 (tre) punonjës karpentier*
- **2 (dy) punonjës hekurkthyes**
- *2 (dy) punonjës elektrikistë*

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; deshmite e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

- Operatori Ekonomik nuk është i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B, çka bie në kundërshtim me me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16.
- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Bami” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) kamionçinë përkatësisht me targa KR 7049 A. Pas verifikimit të dokumentacionin shoqërues për mjetin e deklaruar si më lart, u konstatua se kamionçina me targë KR 7049 A ka kapacitet mbajtës 2.5 Ton. Për sa më lart, Operatori ekonomik “Bami” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 ton”*.
- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Bami” shpk nuk ka deklaruar se disponon 1 (një) Kamion me kapacitet mbajtës 10 ton deri në 15 ton, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Kamion me kapacitet mbajtës 10 ton deri në 15 ton.*
- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Bami” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobetoniere përkatësisht me targa KR 8702 A. Pasi u verifikua dokumentacioni shoqërues për mjetin e deklaruar si më lart, u konstatua se mjeti është deklaruar në procedurën me objekt: “Rikonstruksion i trotuarëve dhe rrugës “Hoxha Tahsim” dhe “Xhanfize Keko” për të cilën Operatori ekonomik ka lidhur kontratë Sipërmarrje nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë dhe është në proces zbatimi. Për sa më lart, Operatori ekonomik “Bami” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, gërma “f”.

- Pasi verifikimit të Shtojcës 10 u konstatua se mjete Autobot uji me targë AA 951 FE rezulton të jetë i montuar = Kamion + depozitë uji, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17 ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobot uji”*.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Bami” shpk, referuar Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

8.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk

- Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur të plotë *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 (pa zërat e punimeve dhe cmimet sipas preventivit)*, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta, pika 1, gërma “c”.
- Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur Shtojcën 5, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta, pika 1, gërma “a”.
- Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur Shtojcën 10, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta, pika 1, gërma “d”.
- Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur Shtojcën 11, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta, pika 1, gërma “dh”.
- Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta, pika 1, gërma “e”.
- Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 2 të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2015, 2016, 2017) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se 50% e vlerës së fondit limit perkatesisht: 64,349,283.55 (gjashtëdhjetë e katër milionë e treqind e dyzet e nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH”*, pasi nuk ka paraqitur xhiron e kërkuar.
- Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve.....”*, pasi nuk ka paraqitur deklaratë për drejtuesin teknik të punimeve.
- Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 4, gërma “a” të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Vërtetim të lëshuar nga*

Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Nëntor 2017 - Nëntor 2018.....”, pasi nuk ka paraqitur vërtetim nga administrata Tatimore.

- Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 5 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë/1(një) inxhinier Mjedisi (i pajisur me certifikate (e vlefshme) lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis)”, pasi nuk ka paraqitur certifikate (e vlefshme) lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.*
- Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për mjekun cka bie në kundërshtim me pikën 6 të kapaciteti teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit.
- Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për makineritë dhe mjetet e kërkuara cka bie në kundërshtim me pikën 17 të kapaciteti teknik të Dokumentave standarte të Tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Geci” shpk**, me adresë: **Tirana International Hotel, Sheshi Skënderbej, Nr.8, Tirane.**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **121,883,207.78** (njëqind e njëzetë e një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e shtatë pikë shtatëdhjetë e tetë) **lekë** pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 01.02.2019

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk u paraqit asnjë ankesë.